

## SPECIFIKIME TEKNIKE

### **OBJEKTI : RIKONSTRUKSION OBJEKTE SHKOLLORE + TERENE**

#### **PRISHJE E SUVATIMIT**

Prishja komplet e te gjithë siperfaqes se suvatuar deri ne daljen e muratures, larje e siperfaqeve te prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine , spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te objektit si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund heqjes se suvase.

#### **TRANSPORTET**

Ngarkim dhe transport me shkarkim, me cfaredo mjeti, te materialit qe rezulton nga germimet, prishjet etj... te cfaredo natyre dhe lloji, edhe n.q.s. eshte i lagur, per largimin e tyre nga kantieri ne cfaredo distance dhe niveli, duke perfshire shkarkimin dhe rrafshimin nese eshte i nevojshem.

#### **PUNIME SHITESASH**

Shtresat qe do te behen brenda ambientit te shkolles jane shtresa betoni M-150 ,5 cm , shtresa niveluese me beton C 7/10 2-5 cm shtrese pllaka porcelani importi mat cilesi e mire .

Pllaka duhet zgjedhur per secilin ambient , duke mare parashysh nevojat dhe kriteret qe ato duhet ti permbushin .Klasifikimi i pllakave te behet sipas ketyre kriterëve

1. Menyra e dhenjes se formes se pllakes
2. marja e ujit
3. dimesjonet e pllakave vetite e siperfaqes
4. vecorite kimike \_\_fizike
5. sigurimi kundra ngrices
6. Pesha / ngarkesa e siperfaqes
7. koficienti i reshqitjes

Ne shtresat me pllaka jane parashikuar shpenzimet e pllakave , dhe materjalet plotesuase si kole cemento rere per nivelim , si dhe shpenzime punetori per sigurimet shoqerore .

#### **PLINTUSA**

Zokol plintusi ne qeramike me ngjyre te perafert me pllakat ekzistuese te dyshemese me lartesi 8 cm, i vendosur ne veper me kol, duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

#### **PUNIME SUVATIMI**

Suvatimi i brendeshem do te realizohet mbasi te jene bere te gjithë istalimet elektrike Perpara se te suvatohet do te behet sprucimi i mureve dhe tavaneve .Para sprucimit siperfaqja qe do te suvatohet te laget mire me uje . Sprucimi i mureve dhe i tavaneve do te behet me llac cemento te lenget per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqes se muratures , duke perfshire skelat e sherbimit dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht sprucimin. Suvatimi me drejtus i realizuar me nje shtrese me trashesi 2 cm llac bastard M-25 me permbajtrje rere e lare 0.005 m<sup>3</sup> , llac gelqere M-1 :2 ,0.003 m<sup>3</sup>, cemento 400, 6.6 kg e uje i aplikuar me paravendosje te drejtuesve ne mure e lemuar me mistri e berdaf ,duke perfshire skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht suvatimin.

## **DYER TE BRENDSHME**

Fumizim dhe vendosje dyersh te brendshme tamburato te rimeresuar permasat e se ciles duhet te percaktohen nga kontraktori me MDF e ndertuar nga : nje kase MDF e cila do jete sa gjeresia e murit , me trashesi 3 cm, i imprenjuar, me permasa sipas gjeresise se muratures dhe e fiksuar ne takot prej druri te paravena ne murature; dere e formuar me kornize me seksion minimal 10x4 cm e i kompletuar me te pakten tre mentesha prej 14 cm secila, nje brave metalike me celes automatik me 3 celesa, doreza alumini dhe piastrat e gojezat perkatese alumini, duke perfshire punirne murature, skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte. Ne kanaten e deres do kete nje sipërfaqe me xham me dimensione 20 x 50 cm.

## **PUNIME BOJATISJE**

Ne zerin e lysterjes eshte parashikuar lysterje me hidroplastike importi brenda objektit. Lysterja do te jete e nje cilesie te larte duke parashikuar te gjitha kushtet teknike , per kete qellim dhe jane parashikuar dhe shpenzimet dhe sigurimet shoqerore te punetoreve , si dhe materialet e nevojshme sipas normativave ne fuqi.

## **PUNIME ELEKTRIKE**

Aksesoret e instalimeve elektrike do te specifikohen ne menyre te detajuar ne pikat e meposhtme te ketij seksioni  
Te gjithë materialet duhet ti plotesojne kerkesat e pergjithshme te kushteve teknike te zbatimit qe duhet te plotesojne keta asensore dhe ne pergjithesi instalimet elektrike .  
Instalimi elektrik duhet te jete i plote ne te gjitha pikepamjet sic eshte treguar edhe ne projekt , me skica pershkruar me specifikimet e udhezimet e projektuesit .  
Montimi duhet te perfshije me emergji elektrike te gjithë paisjet elektrike te afuara  
Pika e furnizimit te pajisjeve duhet te jete kutija terminale furnizuese ne pajim ose aparati i afert mbylles .

## **PUNIME HIDROSANITARE**

Germime dheu

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 germim dheu themel me krah , panvaresisht nga kategoria e tokes . Germimi te behet duke patur parasysh permasat sipas profilit dhe kushtet teknike .

Shtrese material rere ose materjal i bute mbi dhe nen tubo

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 shtrese material rere ose materjal I bute sipas zerit te preventivit mbi dhe ne tubot e P.V.C. ne cmim futet teresia e shpenzimeve per zgjedhjen e materialit rere ose materjal I bute sipas zerit te preventivit, transportin shperndarjen e tij mbi dhe ne tubot plastike. Materiali rere ose materjal I bute sipas zerit te preventivit te plotesojte te gjitha kushtet teknike te mos kete gure.

Punime banje

Ne banje do te behen komplet instalimet hidraulike si dhe paisjet komplet do te vendosen te reja.

Ne lartesine 1.5 m do te vishen muret me plaka majolike te cilat do te plotesojne standartet .

## **GERMIM DETYRUAR DHEU SHKARKIM NE MJET**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>3</sup> germim dheu themel , kanal anesor beton ose te jo beton panvaresisht nga kategoria e tokes ose menyra e realizimit te tij me krah ose me mjete te mekanizuar Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor. Ne cmim perfshihet dhe transporti I dherave ne nje vend te caktuar nga Investitori por jo me larg se 3 km nga objekti.

### **BETON C – 7 /10**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>3</sup> beton C – 7 / 10 per ndertimin e shtreses te betonit nen pllake sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas faktit, duke respektuar kuotat .Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , dhe hedhjen ne veper . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuar e betonit. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Te perdoret rere guri.

### **SHTRESE STABILIZANTI 10 CM+SPERKATJE ME BITUM**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>2</sup> shtrese cakell makinerie me trashesi 10 cm me pjerresi dhe sperkatje 0.5 l bitum / m<sup>2</sup> duke siguruar pjerresite per te mos mbajtur uje sheshi, ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve , transportin shperndarjen e tij ne siperfaqen e sheshit dhe ngjeshjen e tij me rul 10 ton sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete I prodhuar me makineri me fraksion deri 30 mm , .Materiali duhet te ngjishet disa here me rul dhe kihet parasysh profilimi I sheshit. Mbi shtresen hidhet prajmer ndertuar me bitum jo me pak se 4 kg per m<sup>2</sup> dhe mbi prajmerin hidhet nje shtrese granil. Shtresa te ruhet nga ndotjet . Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e cakellit

### **SHTRESE BINDER 3 CM**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>2</sup> shtrese binder ne shesh, me trashesi 3 cm pas ngjeshjes me rul 10 ton shtrimi me makineri , dhe te sigurohen pjerresite per te mos mbajtur uje sheshi, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e binderit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne shesh dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi i binderit te behet pasi jane pergatitur nenshtresat sipas kushteve teknike , testeve te bera te nenshtreses : Shtrimi te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Materiali i binderit te plotesoje te gjitha kushtet teknike shoqeruar me certificate cilesie.Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e binderit

### **SHTRESE ASFALTOBETONI 3 CM**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>2</sup> shtrese asfaltobetoni ne shesh, me trashesi 3 cm, pas ngjeshjes me rul 10 ton , dhe sigurohen pjerresite per te mos mbajtur uje sheshi, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e asfaltit , transportin sipas

kushteve teknike shperndarjen e tij ne shesh dhe ngjeshjen e tij me rul 10 ton sipas kushteve teknike. Shtrimi i asfaltit te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Asfaltobetoni te plotesoje te gjitha kushtet teknike , shoqeruar me certificate cilesie .Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit.

Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e asfaltit.

#### **F.V. BORDURA PARAFABRIKAT BETONI C – 16 /20.**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 ml bordure ne rruge dhe trotuar. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e bordureve parafabrikat betoni, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre me topograf. Fiksimi I bordurave do te behet ne beton C – 16 / 20. Bordurat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

